



Universiteti
i Arteve
Tiranë





Prof. Petrit MALAJ
(Rektor/Rector)

Me fillimin e vitit akademik 2011 – 2012 shkolla jonë është shndërruar nga “Akademi e Arteve” në “Universiteti i Arteve”. Personalisht ndjehem krenar që së bashku me kolegët pedagogë dhe të gjithë bashkëpunëtorët dhe sigurisht me ndihmën e studentëve, arritëm që shkollën tonë ta ngremë në një nivel më të lartë institucional, duke synuar në rritjen e standardeve të ofertave tona akademike.

Kam dëshirë që të përsëndes të gjithë studentët e shkollës sonë dhe ti siguroj ata se në konsideratën time dhe të gjithë trupës pedagogjike, ata jenë pjesë e një familjeje të madhe, e cila u gjendet pranë hap pas hapi në rrugën e formimit dhe përmbushjes së tyre artistike.

Njëkohësisht përgëzoj dhe gjej rastin të falenderoj për kontributin e vërtetë në zhvillimin e shkollës sonë, trupën pedagogjike, gjithë kolegët e bashkëpunëtorët të cilët i falenderoj për gjithçka bëjnë ditë pas dite për edukimin profesional të artistëve të rinj.

Dua gjithashtu të kujtoj me plot krenari të gjithë personalitetet e shquara që kanë dalë nga shkolla jonë ndër vite, të cilët me frymëmarrjen e tyre artistike i kanë dhënë frymë ekzistencës së kombit tonë, ndër ditë të vështira e të lumtura.

Ngritja në Universitet përkon me një ngjarje të rëndësishme për jetën e shkollës sonë, duke na risjellë në mendje ngjarje që vërtetë tashmë i përkasin historisë, por që janë ngurtësuar përjetësisht si pjesë e traditës dhe e trashëgimisë sonë artistike e profesionale. 45 vjet më parë nisi viti i parë akademik në Institutin e Lartë të Arteve, një shkollë arti e lindur nga bashkimi i Konservatorit Shtetëror të Tiranës, Shkollës së Teatrit dhe Shkollës së Arteve Pamore.

Sot Universiteti i Arteve ka mbi 300 pedagogë, efektivë e të ftuar, mes të cilëve spikasin një numër i madh emrash të shquar personalitetesh të artit shqiptar. Ky fakt përbën një pikë të fortë të Universitetit të Arteve në sigurimin e një cilësie të lartë në formimin artistik e profesional të studentëve. Në këtë këndvështrim synimi ynë kryesor është shtimi i përpjekjeve për ngritjen e nivelit të pedagogëve më të rinj si nga pikëpamja e mësimdhënies ashtu edhe nga pikëpamja shkencore. Qenia e Universitetit të Arteve ka vendosur përballë nesh sfida të mëdha për sa i takon fuqizimit të aspekteve shkencore të ofertës dhe veprimtarisë sonë akademike.

Të gjithë ne duhet ta ndjejmë veten tashmë si pjesë e një organizmi të madh, që për nga vetë profili dhe natyra e shkollës ofron dinamizëm të garantuar. E si pjesë e këtij organizmi kemi detyrimin të kontribuojmë qoftë edhe me elementët më të thjeshtë në përmirësimin e

aspekteve të ndryshme të tij. Rasti i 45 vjetorit të shkollës sonë shënon fillimin e një evolucioni të rëndësishëm në konceptin dhe mentalitetin e edukimit artistik e shkencor. Ne të gjithë duhet të jemi pjesë e këtij evolucioni, sepse vetëm kështu, edhe si individë mund të arrijmë të zhvillohemi dhe të realizojmë sipërmarrje të suksesshme.

Faleminderit !

Upon the beginning of the academic year 2011 – 2012, our school has been converted from the “Academy of Arts” into the “University of Arts”. Personally, I feel honored that together with the professors colleagues and all the collaborators and of course with the assistance and help of the student, we managed to raise our school at the highest institutional level, aiming at increasing and enhancing the standards of our academic offers.

I would like to greet all the students of our school and ensure them that in my consideration and in the consideration of the entire pedagogic team, they are part of a big family, which is close to them step by step in the way of their artistic formation and realization.

At the same time, I congratulate and take the advantage to thank for the real contribution in the development of our school the pedagogic team, all the colleagues and the collaborators whom I thank for everything they do day after day for the professional education of the new artists.

I would like to remember in full pride all the outstanding personalities that have come out of this school over the years, who with their artistic breathing and aspiration have given spirit to the existing of our nation, in its difficult and happy days.

The rising to University coincides with a very important event for the life of our school, bringing to our mind events that now belong to the history, but which have been solidified eternally as part of our artistic and professional tradition and heritage. 45 years ago began the first academic year in the High Institute of Arts, an art school emerging from the merger of the State Conservator of Tirana, the School of Theater and the School of Visual Arts.

Today the University of Arts has over 300 professors, effective and invited; among them outstanding a great number of well known personalities of the Albanian art. This fact constitutes a strong point of the University of Arts for ensuring a high quality in the artistic and professional formation of the students, From this point of view, our main goal and objective is the addition of the efforts for increasing the level of the youngest professors from the teaching point of view and from the scientific point of view. Being the University of Arts has faced us with big challenges as it regards the strengthening of the scientific aspects of our academic offer and activity.

All of us should feel now part of a big organization that due to the profile and the nature of the school offers a guaranteed dynamism. And, as part of this organization we have the obligation to contribute even through the simplest elements for the improvement and enhancement of the different aspects of it. The event of the 45 anniversary of our school marks the beginning of an important evolution in the concept and the mentality of the artistic and scientific education. We all should be part of this evolution, because only in this way, also as individuals we can manage to develop and realize successful enterprises.

Thank you!

Prof. Petrit Malaj
Rektor/Rector
Universiteti i Arteve/ University of Arts



Universiteti i Arteve është institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë me karakter artistik në Shqipëri, që ofron Diplomë Universitare Bachelor, Master në Arte, në Muzikë, Arte të Bukura dhe Artet Skenike, Master Profesional si dhe studime të ciklit të tretë “Doktoraturë”.

I themeluar më 1966 si Instituti i Lartë i Arteve i cili bashkoi tre institucione artistike: Konservatorin Shtetëror të Tiranës, Shkollën e Arteve të Bukura dhe Shkollën e Lartë të Aktorëve “Aleksandër Moisiu”, më 1990, me ndryshimet në sistemin arsimor, Instituti i Lartë i Arteve u ngrit në nivel Universiteti dhe u emërua “Akademia e Arteve” duke u shndërruar në Maj të vitit 2011 si “Universiteti i Arteve”.

Aktualisht Universiteti i Arteve ka tre fakultete:

Fakultetin e Muzikës,

Fakultetin e Arteve të Bukura

Fakultetin e Artit Skenik

duke u bërë kështu institucioni unik në vend për përgatitjen e talenteve të reja në të gjitha fushat e artit dhe që ka marrë përsipër të sjellë prurjet më të mira, më kompetitive e më origjinale për institucionet artistike të vendit si dhe për jetën shoqërore e artistike dhe produktin shpirtëror shqiptar në të gjitha trevat shqipfolëse.

Qëllimi kryesor i saj është të ofrojë arsimim të lartë profesional dhe veprimtari krijuese në fushën e artit dhe të kulturës, të thellojë kualifikimin profesional e shkencor të specialistit të lartë në fushën e artit e të kulturës, si dhe të kontribuojë në rritjen e standarteve të demokracisë e të qytetërimit . E gjithë rruga mbi 45 vjeçare e Universiteti të Arteve ka qënë një rrugë e shtimit sistematik të specialiteteve dhe vitet e fundit në implementimin e Kartës së Bolonjës.

Kontributi i pedagogëve dhe studentëve të këtij institucioni në vite ka bërë që jeta artistike të jetë ndikuar fuqimisht dhe pozitivisht prej krijimtarisë dhe interpretimit të tyre. Është e pamundur që të përmenden të gjithë emrat e shquar të ILA, AA, UA në vite, por personalitetet si Zadeja, Harapi, Ibrahim, Antoniu, Madhi, Lara, Papparisto, Stringa, Laro, Kristidhi, Shiroka, Shestani, Krantja, Spahivogli, Malo, Roshi, Frashëri, Prosi, Pelinku, Mani, Furxhi, Oktrova, Ashiku, Plasari, Hasko, Flloko, Paskali, Paço, Shijaku, Rama, Jukniu, Buza, Dhrami, Dule, Leka, Oseku si dhe më të rinjtë të cilët sot marrin pjesë aktive në jetën artistike shqiptare ashtu edhe jashtë vendit, do të ishin pika të rëndësishme të ndalesës së kujtesës së të gjithëve për të kuptuar dhe pozicionuar sa më saktë rolin dhe vendin e ILA, Akademisë së Arteve sot Universiteti i Arteve, në jetën dhe prodhimtarinë shpirtërore shqiptare.

Aktualisht në auditorët e UART studiojnë 940 studentë, të cilët udhëhiqen nga një staf pedagogjik prej 408 asistentë, pedagoge, profesorë të asociuar dhe profesorë, prej të cileve 127 janë me kohë të plotë.

Trupa mësimdhënëse dhe bashkëpunëtorët e Fakulteteve janë emra të mirënjohur në fushat ku operojnë – muzikantë, piktorë, skulptorë, regjisorë teatri dhe filmi/televizioni, aktorë, skenografë dhe koreografë - me njohuri të gjera teorike dhe praktike. Artistët e përgatitur në këtë institucion përbëjnë një forcë gjeneruese në jetën kulturore Shqiptare.

Ambientet në UART

Në institucionin më prestigjioz ku zhvillohet dhe përparon në mënyrë shkencore edukimi artistik i brezave, ambientet e UART krijojnë një marrëdhënie interaktive, ku studentët kanë mundësinë të studiojnë në një mjedis të specializuar dhe të angazhohen në punë krijuese.

Kompleksi i Universitetit të Arteve

Universiteti i Arteve ndodhet në zonën “Ansambël Monument Kulture”, e shpallur me V.K.M Nr 180 dat.13.04.2000. Zone urbane, studimi i së cilës daton në vitin 1943 me arkitekt projektues Dr Arch. Ivo. Lambertini dhe arkitekt konsulent Dr. Ing. Arch. Ferdinando Poggi, aktualisht zonë qendrore qeveritare, universitare por edhe me ndërtesa të rëndësishme institucionale.

Kompleksi Urbanistik-Arkitektonik i Universitetit të Arteve përbëhet nga korpusi qendror dhe nga ndërtesat 2-3 katëshe të ndërtuara rreth viteve 70-të.

Korpusi qendror me arkitekturë dhe konstruksion tip i vitit 1939-40 dhe autor ark G.BOSIO,

përfaqëson në mënyrë dinjitoze një Institucion Social-Kulturoro-Arsimor si “Universiteti i Arteve”, i vetmi institucion i këtij lloji në vendin tonë.

Në përbërje të kësaj ndërtese është edhe “Salla e Madhe e Koncerteve” me kapacitet 600 vende, më e mira e këtij lloji në vendin tonë duke plotësuar të gjitha standartet teknike, arkitektonike dhe nga pikëpamja e akustikës.

Ndërtesat e ndërtuara në vitet 60-70-të ndodhen në perëndim, jugperëndim, veri të territorit të Universitetit të Arteve.

Në këto ndërtesa zhvillojnë mësimin

Në këto ndërtesa zhvillojnë mësimin:

- a) **Fakulteti i Muzikës;**
- b) **Fakultetit i Artit Skenik;**
- c) **Fakulteti i Arteve të Bukura;**

Të dhëna të përgjithëshme për sipërfaqen, ambientet, auditorët, sallat etj. (viti 2011)

Sipërfaqe e përgjithëshme e territorit: 13.870 m²

Sipërfaqe totale ndërtimi e përafërt: 15.450 m² me një organizim dhe ndarje fizike të ambienteve si më poshtë:

- Numri i përgjithshëm i auditorëve 6;
- Numri i përgjithshëm i klasave 87;
- ektoriume - 2 me kapacitet 220 dhe 100 studentë;
- Salla të tjera 12 ndër të cilat veçojme, salla baleti dhe koreografie me sip 100 m², dhe 110 m², palestër sportive etj.;
- Laboratorë dhe ateljerë 12;
- Numri i përgjithshëm i ambienteve administrative - 22 zyra;
- Sipërfaqe të gjelbëruara;
- Parkim për 60 autovetura;
- Sistem ngrohje qendror, me kalaja individuale dhe kondicionerë apo sistem aspirimi;

Në ndërtesat e Kompleksit ndodhen edhe:

- “Salla e Madhe e Koncerteve” në UA me kapacitet 600 vende;
- Salla “Black-Box” me kapacitet 220 vende;
- “Galeria e Arteve të Bukura” sip. 244 m²;
- Salla “Çesk Zadeja” sip 200 m²;
- Anfiteatri veror me kapacitet 400 vende;
- Biblioteka Shkencore e Akademisë së Arteve me sip rreth 500 m²

Të Dhëna të Përgjithëshme për numrin e studentëve, pedagogëve dhe punonjësve të shërbimit.

Numri i përgjithshëm i studentëve rreth 940.

- Fakulteti i Muzikës: 379 studentë (njezet programe studimi)
- Fakulteti i Artit Skenik: 242 studentë (pesë programe studimi)
- Fakulteti i Arteve të Bukura: 318 studentë (shtatë programe studimi)
- Numri i përgjithshëm i punonjësve akademike: 127 me kohë të plotë dhe 281 të ftuar.
- Numri i punonjësve të shërbimit: 64

Ritmi i ndryshimeve të treguesve kryesorë:

	Viti	1985	1991	2011
I	Numri i studentëve	332	377	939
II	Numri i punonjësve	135	194	191
III	Sipërfaqe ndërtimi/m ²	10250	14450	15450

Duke ju referuar treguesve të mësipërm, vihet re se numuri i studentëve është rritur me 2.8 herë ose nga 332 studentë në vitin 1985, sot studjojnë rreth 940 studente.

Numri i të diplomuarve sipas fakulteteve që nga krijimi.

- FAB rreth 1200 të diplomuar
- FAS rreth 1500 të diplomuar
- FM rreth 2350 të diplomuar

Punësimi i të diplomuarve dhe angazhimi i studentëve në aktivitete profesionale. Mundësitë e punësimit në Shqipëri. Prezantimi dhe punësimi në nivel ndërkombëtar

Përgatitja për tregun e punës është një nga prioritetet e Universitetit të Arteve. Është fakt që shumë nga studentët tanë futen në tregun e punës që gjatë kohës së studimeve duke u angazhuar si në aktivitete artistike kombëtare ashtu dhe në ato racionale dhe më tej edhe ndërkombëtare.

Fakulteti i Muzikës

Të diplomuarit në FM punojnë sot në Teatrin e Operas dhe Baletit, Ansamblin Popullor, Orkestren Simfonike të RTSH në Orkestren Frymore të Ushtrisë, mësues në licetë artistike në Tiranë, Durrës, Fier, Shkodër, Berat, Vlorë, Elbasan, Gjirokastrë, Korçë, në shkollat e muzikës në Tiranë si dhe mësues të muzikës në të gjitha shkollat e Shqipërisë, po ashtu edhe në orkestra të tjera si Cammerata e Tiranës, Filarmonia e Akademisë së Arteve, Orkestra e Dhomës e Tiranës. Të diplomuarit pranë fakultetit të muzikës janë sot pjesë e orkestrave dhe grupeve të njohur pranë televizioneve në Shqipëri, mjaft të kujtojmë Top Show, E diela shqiptare, E Diell, Gjeniu i vogël, Maratona e kenges etj. Të diplomuarit në FM janë sot redaktorë muzike pranë radiove dhe televizioneve apo konsulentë muzikorë. Muzika Jazz, Rock, Festalet e ndryshme të muzikës moderne kanë një angazhim të madh të studentëve dhe të të diplomuarve të FM-së.

Janë të paktën 350 muzikantë shqiptarë (instrumentistë, këngëtarë, dirigjentë, dhe kompozitorë) të cilët falë nivelit të lartë profesional, punojnë në profesionin e tyre si pedagogë dhe interpretues në institucione artistike (shkolla, orkestra simfonike, teatro operash) në Itali, Greqi, Francë, Gjermani, Kanada, Spanjë, Portugali, SHBA, Belgjikë, Slloveni, Austri, Çeki Argjentinë, Australi, Turqi Zelandë e Re dhe Japoni etj. Po ashtu janë me dhjetëra instrumentistët të cilët janë pjestarë të bandave frymore profesioniste dhe gjysmë-profesioniste nëpër botë.

Gjithashtu, mjaft artistë shqiptarë që jetojnë në atdhe, janë përfshirë në kalendarët e disa prej aktiviteteve më prestigjioze që zhvillohen nëpër botë.

Megjithë historinë e shkurtër të lëvrimin të muzikës klasike në Shqipëri, kjo pjesë e jetës shqiptare mbetet një nga më avanguardet dhe më të azhornuarat, si rrjedhim edhe më e përgatitur përballë tregut muzikor evropian dhe botëror.

Solistë të shquar të diplomuar në shkollën tone, kanë dhënë gjithashtu një kontribut të rëndësishëm duke çuar në këtë mënyrë në vlerësimin gjithnjë e më pozitiv të shkollës shqiptare të artit në La Scala, Metropolitan, Convent Garden dhe në dhjetra institucione të artit e Festivale prestigjioze në mbarë botën.





Fakulteti i Artit Skenik

Të diplomuarit në këtë fakultet janë sot aktorë, regjizorë e skenografë në Teatrin Kombëtar dhe në teatrot pranë bashkive të qyteteve të ndryshme të Shqipërisë si në Fier, Shkodër, Durrës, Korçë, Elbasan, Vlorë etj. Shumë prej tyre janë sot regjizorë e skenografë pranë TVSH-së dhe televizioneve të shumta kombëtare dhe lokale në Shqipëri. Të shumtë janë aktorët dhe regjizorët të cilët organizojnë dhe marrin pjesë në spektakle mjaft të njohur në Shqipëri si Portokalli, 2XL, telenovela, telefilma apo edhe filma artistikë. Një pjesë e tyre janë dublantë në filma të transmetuar nga televizionet shqiptare si dhe folës në televizione dhe radio kombëtare apo lokale. Skenografitë, si pjesë e rëndësishme e çdo eventi artistik, janë shpesh produkt i të diplomuarve të këtij fakulteti. Kooreografia është një degë e rëndësishme e këtij fakulteti të diplomuarit e të cilës do ti gjeni në Teatrin e Operas dhe Baletit apo Ansamblin Popullor, mësues në Shkollën e Baletit apo në shkolla private dhe kurse të dansit. Po ashtu koreografë në spektaklet periodike pranë TVSH-së dhe televizioneve të tjera si Top Channel, TVKlan, Vizion+ etj. si dhe në spektakle të ndryshme, në realizimin e videoklipeve apo ideimin dhe realizimin e reklamave në radio dhe televizion.

Janë jo të paktë të diplomuarit pranë këtij fakulteti të cilët japin kontributin dhe zhvillojnë jetën e tyre artistike edhe jashtë Shqipërisë si koreografë, skenografë apo edhe aktorë e regjizorë duke shkuar madje deri në Hollywood. Gjithashtu, janë fitues çmimesh ndërkombëtarë me filma artistikë të metrazhit të shkurtër apo edhe dokumentarë, duke dhënë një kontribut të rëndësishëm në përmirësimin e imazhit të vendit tonë.



Fakulteti i Arteve të Bukura

Të diplomuarit pranë këtij fakulteti do ti gjeni në licetë artistikë si në Tiranë, Fier, Vlorë, Shkodër, Korçë etj., në Galerinë Kombëtare të Arteve por edhe në dhjetëra galeri në Tiranë dhe në rrethe. Një pjesë e tyre janë të angazhuar pranë TVSH-së dhe televizioneve të tjera private në Shqipëri. Shumë prej tyre, krahas punës individuale krijuese, janë edhe mësues të vizatimit në të gjitha shkollat e vendit. Mjaft punë të tyre janë sot të ekspozuara në institucionet më të rëndësishme të shtetit shqiptar ashtu si dhe në institucione të rëndësishme private. Po ashtu janë me qindra veprat e tyre në galeritë në Europë dhe në botë si dhe pjesë e koleksioneve private të mijëra individëve. Një pjesë tjetër e veprave të tyre kryesisht skulptura, bazorelieve apo në formë instalacioni, gjenden në ambjentet publike, në parqe publike dhe private, në faqet e pallateve luksoze apo shatërvaneve në disa ndërtesa luksoze biznesi. Shumë të diplomuar pranë këtij fakulteti, japin një kontribut të rëndësishëm dhe punojnë në fushën e Fashion dhe Design si dhe në fushën e fotografisë. Mjaft postera apo koncepte të tjera, po ashtu, punime me të gjitha materjalet (mermer, granil, terra cotta, alabastër, dru etj. etj.) shumë të kërkuara tashmë nga tregu, janë produkt i tyre. Me rritjen e nivelit kulturor të qytetarëve, veprat artistike po bëhen gjithnjë e më shumë jo vetëm një modë por edhe nevojë në ambjentet ku jetojmë dhe punojmë duke krijuar në këtë mënyrë një treg më të gjerë për artistët e diplomuar në këtë fushë.

Janë të shumtë tashmë piktorët, skulptorët dhe artiste pamorë në përgjithësi që punojnë dhe jetojnë tashmë në të gjithë botën duke dhënë në këtë mënyrë edhe një kontribut të rëndësishëm për imazhin e vendit tonë. Mjaft të kujtojmë se janë me dhjetra galeri që mbajnë punët e artistëve tanë në Europë dhe më gjerë. Shumë aktivitete të rëndësishme në nivel botëror kanë pjesë të tyre piktorët dhe skulptorët tanë si Bialja e Venecias etj.



Diploma e AA sot UART është njohur de facto në Europë dhe më gjerë që në vitet 90' pas ardhjes së demokracisë. Është fakt që prezantimi dinjitoz i artistëve shqiptarë, ka ndihmuar thellësisht në përmirësimin e imazhit të vendit tonë.

Trupa mësimdhënëse

Trupa pedagogjike, profesorë me kohë të plotë apo të ftuar janë personalitetet më të shquara të fushës. Ata janë emra të mirënjohur në fushat ku operojnë – muzikantë, piktorë, skulptorë, regjisorë teatri dhe filmi e televizioni, aktorë, scenografë dhe ko-reografë - me njohuri të gjera teorike dhe praktike. Shumica prej tyre kanë marrë çmime artistike dhe tituj kombëtarë e ndërkombëtarë për kontribute të veçanta dhe punë krijuese, me një aktivitet të pasur dhe cilësor profesional në skenat shqiptare dhe botërore, të cilët vazhdojnë traditën duke ngritur edhe më lart nivelin profesional.

Aktiviteti artistik dhe shkencor

Jeta kulturore-artistike dhe shkencore si dhe aktivitete në Sallat dhe galerinë, amfiteatrin dhe ambientet e tjera të Universitetit të Arteve dhe jasht tij.

Jeta artistike, krijuese dhe shkencore brenda sallave dhe ambienteve të UART-it, është mjaft e pasur. Janë me qindra eventet e këtij lloji si në aktivitetet periodike (stina koncertore, ekspozitat etj.) ashtu dhe në programe të mbështetura nga qeveria dhe institucione të tjera private dhe ndërkombëtare siç mund të përmendim Programin “Qyteti i Arteve”, workshopet, tavolinat e rrumbullakëta, master class-et, në bashkëpunim me artistë shqiptarë dhe të huaj etj.

Janë me dhjetra iniciativat private nga menaxherë të artit por edhe nga vetë artistët të cilat angazhojnë studentët tanë që në bankat e shkollës. Orkestra, baletë, opera, teatro, ekspozita të shoqëruara me tourne' të shumtë brenda dhe jashtë shtetit janë veprimtari të shpeshta për studentët dhe pedagogët e UART.

Aktiviteti shkencor pranë fakulteteve, ka pësuar një rritje të ndjeshme gjatë viteve të fundit sidomos në fushën e teknologjisë, kërkimit dhe eksperimentimit si në drejtim të metodologjisë së mësimdhënies ashtu dhe në drejtim të dokumentimit dhe produksionit artistik.

Marrëdhëniet e UART me shkollat homologe në botë dhe në hapsirën shqipfolëse si dhe anëtarësimi në organizma ndërkombëtarë

Forcimi i lidhjeve institucionale me Organizma Ndërkombëtare të Artit, me Akademi dhe Universitete të Artit në Europë, si



edhe rritja e bashkëpunimit me institucionet homologe në hap-sirën mbarëshqiptare, janë prioritet i stadi aktual të Universitetit të Arteve.

Lidhjet me këto institucione homologe në Evropë e më gjerë, antarësimi, bashkëpunimi, pjesëmarrja aktive në workshop-e ndërkombëtare dhe përfaqësimi në aktivitete ndërkombëtare, kanë kontribuar në futjen dhe përdorimin e metodave të reja të mësimdhënies, në pasurimin dhe përmirësimin e programeve që ofron Universiteti i Arteve.

Universiteti i Arteve aktualisht është anëtar me të drejta të plota në:

AEC - Organizata Europiane e Akademive të Muzikës

ECUME - Échanges Culturels en Méditerranée

UNAI - United Nations Academic Impact

UNSHP - Rrjeti i Universiteteve Shqipfolëse

Në kuadër të këtyre anëtarësimeve, UART merr pjesë në: Kongresin e përvitshëm të AEC ku diskutohen problemet koherente të arsimit të lartë në fushën e artit muzikor, merren informacione dhe shembuj të praktikave më të mira, shkëmbim eksperience, etj.;

Simpoziume të përvitshme, takimi i Koordinatorëve të Marëdhënies Ndërkombëtare- i programuar për tu njohur me projekt-programet dhe reformat Europiane në fushën e artit; Gjithashtu, si anëtar i ECUME , studentë e pedagogë të UART marrin pjesë në takimet e përvitshëm të Shkollave të Artit në rajonin e Mesdheut në të tre fushat: muzikë, art dramatik dhe arte pamore.


Aktualisht UART ka marrëveshje bashkëpunimi me : Universiteti i Tiranës (Memorandum Bashkëpunimi), Universiteti i Prishtinës, Universiteti i Tetovës, Universiteti i Arteve Beograd, Universiteti Aristotel i Selanikut, Konservatorin Guido Cantelli të Novarës, Konservatori Jakobo Tomadini Udine;

si dhe

RadioTelevizioni Shqiptar, Teatri Kombëtar i Operas dhe Balletit, Teatri Kombëtar, Teatri i Metropolit, Shkolla Kombëtare Artistike “ Jordan Misja”.

Në kuadër të këtyre marrëveshjeve dy-palëshe të UART me Konservatorë Europeanë të Muzikës dhe Universitete të Artit, ekziston tashmë një kalendar i përvitshëm i aktiviteteve dhe projekteve të përbashkëta si: ekspozita, koncerte apo performanca artistike, ku studentët e UART performojnë artin, njohuritë dhe talentin e tyre. Mund të veçojmë aktivitete të tilla si:

- Organizimi i Ekspozitave të përbashkëta me Akademi



dhe Universitete të Arteve Pamore në vende të Europës Juglindore, SKOMRAHI;

-Takimi i Fakulteteve dhe Akademive të Artit Dramatik, “Ura me Tri Harqe”, aktivitet ku performojnë studentë të universiteteve shqipfolëse, pjesëmarrje në festivale dhe koncerte të përbashkëta;

-Studentë të Fakultetit të Muzikës, në bashkëpunim me konservatorë në Itali, interpretojnë në koncerte të ndryshme, në orkestra të përbashkëta.

Gjithashtu, marrëveshjet e bashkëpunimit të UART me institucionet e artit brenda vendit, janë marrëveshje të cilat në përputhje me ndryshimet në sistemin e arsimit të lartë u krijojnë studentëve kushte dhe hapësirat e duhura për praktikat mësimore sipas programeve të ciklit të parë dhe të dytë.

Pranimet në Universitetin e Arteve

Pranimet në Universitetin e Arteve bëhen vetëm me anë të konkurimit, kriteret e të cilit kanë specifikën e tyre në lidhje me specialitetin dhe programin e studimit të kërkuar.


Kriteret e pranimit pasqyrohen edhe në faqen e web-site-it të Universitetit të Arteve.

Çdo person që ka mbaruar maturën shtetërore ka të drejtë të konkurojë për të ndjekur studimet në UART. Studimet në UART mund t'i ndjekin edhe studentë të huaj bazuar në marrëveshjet dypalëshe ose shumëpalëshe. Studime në UART mund të ndjekin gjithashtu edhe shtetas shqiptarë e të huaj që kanë përfunduar studimet e larta (degë e dytë) kundrejt pagesës së tarifës së caktuar. Personat që kanë mbaruar një program studimi, kanë të drejtë të ndjekin një program të dytë studimi. Edhe në këtë rast ata duhet t'i nënshtrohen konkursit për të studiuar në programin e ri.

Studimet në Universitetin e Arteve

Në Universitetin e Arteve studimet universitare organizohen në sistemin me kohë të plotë, në tre cikle të njëpasnjëshme. Studimet në UART zhvillohen me bazë vitin akademik, i cili organizohet në semestra me leksione, seminare e laboratorë.

Programet e ciklit të parë synojnë të japin njohuri themelore mbi metoda dhe parime artistiko-shkencore në specialitete të ndryshme. Ky cikël përmban jo më pak se 180 kredite dhe zgjatja normale është tre vite në fund të të cilit fitohet diploma Bachelor.



Programet e ciklit të dyte synojnë të japin njohuri të thelluara mbi metoda dhe parime artistiko-shkencore, si dhe edukim për kërkim të pavarur artistiko-shkencor. Ky cikël përmban jo më pak se 120 kredite dhe zgjatja normale është dy vite në fund të të cilit fitohet Master në Arte (MAB) dhe Master Shkencor.

UART ofron Master Profesional në disa programe studimi. Ky cikël përmban jo më pak se 60 kredite dhe zgjatja normale është një vit në fund të të cilit fitohet Master Profesional.

Programet e doktoraturës janë programe të studimeve të ciklit të tretë me karakter plotësisht akademik, që kanë në bazë kërkimin artistiko-shkencor dhe veprimtari krijuese të pavarura.

Pajisja me diplomë

Universiteti i Arteve i pajis studentët që kanë përfunduar të gjitha detyrimet e një programi studimi me diplomën përkatëse, e cila është dokument zyrtar.

Diplomat për ciklin e parë dhe ciklin e dytë shoqërohen me suplementin e diplomës. Ky suplement hartohet në përputhje me kërkesat e hapësirës Evropiane të arsimit të lartë. Ai përshkruan në veçanti natyrën, nivelin, përmbajtjen, rezultatet e studimeve që janë kryer dhe përfunduar me sukses nga mbajtësi i diplomës, etj.

Në Universitetin e Arteve me përfundimin e studimeve fitohet diplomë:

- "Bachelor" në 32 Programe Studimi;
- "Master në Arte" (Master në Artet e Bukura MAB) në 27 Programe Studimi;
- "Master Shkencor" në 1 Program Studimi;
- "Master Profesional" në 4 Programe Studimi;

Këshilli Studentor

Këshillat Studentore në Universitetin e Arteve kanë si objektiv të tyre të promovojnë pjesëmarrjen e studentëve dhe të koordinojnë përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të Institucioneve të Arsimit të Lartë, në strukturat mësimore-kërkimore dhe ato të shërbimeve

Këshillat Studentore shprehin mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të Institucioneve të Arsimit të Lartë, si për planet ashtu edhe për programet e studimeve, rregulloret për veprimtaritë mësimore, të drejtën për të studiuar, cilësinë e shërbimeve, zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive, etj



Fakulteti i Muzikës



Fakulteti i Muzikës u themelua në vitin 1962 në fillim si Konservatori Shtetëror i Tiranës dhe me pas në vitin 1966 si pjesë e ILA-së më pas AA-së që sot emërtohet Universiteti i Arteve.

Pedagogët e parë të këtij fakulteti vinin nga shkolla të njohura Europiane kryesisht të lindjes por edhe të perëndimit. Këta pedagogë të apasionuar, hodhën themelet e një shkolle që edhe sot vazhdon të japë rezultate të mahnitshme në fushën e edukimit muzikor.

Pranë këtij fakulteti gjatë pothuaj 50 vjetëve të ekzistencës së tij, janë diplomuar më shumë se 2300 artistë muzikantë, shumica e të cilëve kanë punuar dhe vazhdojnë të punojnë në profesionin e tyre jo vetëm në Shqipëri por edhe jashtë shtetit sidomos pas viteve 90' (Mbi 80% e të diplomuarve në këtë fakultet sidomos në Harqe, kanto, apo instrumenta fryme kanë punuar ose vazhdojnë të punojnë sot në profesionin e tyre.) Është e vërtetë se pranë këtij fakulteti janë diplomuar disa nga emrat më të rëndësishëm të artit muzikor të cilët e zhvillojnë jetën e tyre artistiko-profesionale në institucionet artistike më prestigjioze të Europës dhe botës duke e bërë këtë fakultet, krahas me fakultetet e tjerë të UART, një nga më konkurruesit në tregun muzikor dhe artistik ndërkombëtar si dhe absolutisht më rezultativi në Shqipëri.

Fakulteti i Muzikës ka rreth 380 studentë, 260 pedagogë dhe ofron rreth 20 programe studimi dhe diploma Bachelor, Master në Arte (MAB), Master Shkencor dhe Master Profesional.

Trupa pedagogjike pranë FM përbëhet nga 47 Prof. Prof. Asoc dhe Dr. ashtu si dhe 213 lektorë një pjesë e të cilëve me Diploma dhe Master të fituar në shkolla të njohura Europiane.

Struktura e Fakultetit të Muzikës është e organizuar në dy departamente:

- 1) Departamenti i Interpretimit (DI), me programet e studimit: Piano, Harqe, Instrumente frymore, Kanto dhe Piano.
- 2) Departamenti Kompozicion-Dirigjim-Muzikologji-Pedagogji (KMD) me programet e studimit: Kompozicion, Dirigjim, Muzikologji dhe Pedagogji Muzikore.



Që prej vitit 2008 Fakulteti i Muzikës ka përshtatur strukturën e re universitare (sipas Kartës së Bolonjës) me tre cikle mësimore. FM në vite ka organizuar dhe studime pasuniversitare.

FM ofron studime dhe diploma Bachelor në 20 programe studimi. Gjithashtu ofrohen studime Master në Arte në 15 programe studimi, Master Shkencor në 1 program studimi si dhe Master Profesional në 4 programe studimi si më poshtë:

Diplomë “Bachelor” në Programet e Studimit:

- | | |
|---------------|-------------------------|
| 1) Piano; | 12) Trombë; |
| 2) Violinë; | 13) Trombon; |
| 3) Violë; | 14) Bastub; |
| 4) Violonçel; | 15) Fizarmonikë; |
| 5) Kontrabas; | 16) Kanto; |
| 6) Kitarë; | 17) Kompozim; |
| 7) Flaut; | 18) Dirizhim; |
| 8) Klarinetë; | 19) Muzikologji; |
| 9) Oboe; | 20) Pedagogji muzikore; |
| 10) Fagot; | |
| 11) Korno; | |

“Master në Arte” (Master në Artet e Bukura) në Programet e Studimit:

- | | |
|--------------------|-----------------|
| 1) Pianist; | 9) Oboist; |
| 2) Violinist; | 10) Fagotist; |
| 3) Violist; | 11) Kornist; |
| 4) Violonçelist; | 12) Trombist; |
| 5) Kontrabasist; | 13) Trombonist; |
| 6) Këngëtar lirik; | 14) Dirizhor; |
| 7) Flautist; | 15) Kompozitor; |
| 8) Klarinetist; | |



“ Master Profesional” në Programet e Studimit:

- 1) Kitarë;
- 2) Fizarmonikë;
- 3) Pedagogji muzikore;
- 4) Bastub;

“Master Shkencor” në Programin e Studimit:

- 1) Muzikologji;

Fakulteti i Muzikës zhvillon një jetë artistike aktive, të programuar sipas një kalendari shtrirë në dy të stinë koncertore me pjesëmarrje të studentëve dhe pedagogëve. Koncertet mbahen në sallën e madhe të Universitetit të Arteve, Sallën “Çesk Zadeja, dhe në sallën Black-Box thuhet në çdo javë të vitit akademik. Këtu përfshihen edhe koncertet me vepra të studentëve të klasës së kompozicionit, krahas formacioneve të ndryshme të muzikës së dhomës. Shumë studentë ftohen rregullisht në sezonet e institucioneve artistike qendrore si TKOB, AP, Orkestra e RTSH si solistë apo si pjestarë të orkestrave, koreve apo formacioneve të tjera muzikore duke u bërë kështu një trampoline e rëndësishme për të ardhmen e tyre.

Pranë FM-së funksionojnë:

- dy orkestra sinfonike;
 - një orkestër frymore;
 - një Big Band;
 - dy orkestra harqesh;
 - 2 klasa opera;
 - kori;
 - si dhe mbi 50 ansamble dhome, të cilët, krahas planit të detyruar mësimor, mbajnë koncerte të programuara brenda stinëve koncertore.
- Mjediset mësimore të FM janë të përqendruara në godinën kryesore të Akademisë së Arteve, ku ndodhet edhe zyra e Dekanit të FM dhe sekretaria e fakultetit si dhe në një godinë të pjesës së mbrapme të shkollës e pajisur gjithashtu me një numër



studiosh individuale si edhe me lektoriumin e Universitetit të Arteve.

Krahas sallës së madhe të koncerteve në godinën qendrore të FM gjendet Salla “Çesk Zadeja”, e cila shërben kryesisht si mjedis pune i orkestrave por edhe për mbajtjen e koncerteve të muzikës së dhomës dhe organizimin e seminareve, workshope-ve, etj. Një mjedis tjetër i rëndësishëm pune është edhe Fonoteka e cila ndodhet në godinën e pasme të Universitetit të Arteve, përbri Sallës së Bibliotekës.

Mundësitë e punësimit:

Të diplomuarit në FM punojnë sot në Teatrin e Operas dhe Baletit, Ansamblin Popullor, Orkestren Simfonike të RTSH në Orkestren Frymore të Ushtrisë, mësues në licetë artistikë në Tiranë, Durrës, Fier, Shkodër, Berat, Vlorë, Elbasan, Gjirokastër, Korçë, në shkollat e muzikës në Tiranë si dhe mësues të muzikës në të gjitha shkollat e Shqipërisë, po ashtu edhe në orkestra të tjera si Cammerata e Tiranës, Filarmonia e Akademisë së Arteve, Orkestra e Dhomës e Tiranës. Të diplomuarit pranë fakultetit të muzikës janë sot pjesë e orkestrave dhe grupeve të njohur pranë televizioneve në Shqipëri, mjaft të kujtojmë Top Show, E diela shqiptare, E Diell, Gjeniu i vogël, Maratona e kenges etj. Të diplomuarit në FM janë sot redaktorë muzike pranë radiove dhe televizioneve apo konsulentë muzikorë. Muzika Jazz, Rock, Festalet e ndryshme të muzikës moderne kanë një angazhim të madh të studentëve dhe të të diplomuarve të FM-së.

Janë të paktën 350 muzikantë shqiptarë (instrumentistë, këngëtarë, dirigjentë, dhe kompozitorë) të cilët falë nivelit të lartë profesional, punojnë në profesionin e tyre si pedagogë dhe interpretues në institucione artistike (shkolla, orkestra simfonike, teatro operash) në Itali, Greqi, Francë, Gjermani, Kanada, Spanjë, Portugali, SHBA, Belgjikë, Slloveni, Austri, Çeki Argjentinë, Australi, Turqi Zelandë e Re dhe Japoni etj. Po ashtu janë me dhjetëra instrumentistët të cilët janë pjestarë të bandave frymore profesioniste dhe gjysmë-profesioniste nëpër botë.

Gjithashtu, mjaft artistë shqiptarë që jetojnë në atdhe, janë përfshirë në kalendarët e disa prej aktiviteteve më prestigjioze që zhvillohen nëpër botë.

Megjithë historinë e shkurtër të lëvrimin të muzikës klasike në Shqipëri, kjo pjesë e jetës shqiptare mbetet një nga më avanguardet dhe më të azhornuarat, si rrjedhim edhe më e përgatitur përballë tregut muzikor evropian dhe botëror.

Solistë të shquar të diplomuar në shkollën tone, kanë dhënë gjithashtu një kontribut të rëndësishëm duke çuar në këtë mënyrë në vlerësimin gjithnjë e më pozitiv të shkollës shqiptare të artit në La Scala, Metropolitan, Convent Garden dhe në dhjetra institucione të artit e Festivale prestigjioze në mbarë botën.



Fakulteti i Arteve të Bukura



Fakulteti i Arteve të Bukura në Tiranë u themelua në 1959 dhe që nga ajo kohë ky Institucion i është përkushtuar edukimit të artistëve profesionistë nga artistë profesionistë dhe njohës të mirë të historisë dhe teorisë së artit.

Fakulteti ndodhet në Kompleksin e Godinave Universitare në Sheshin “Nënë Tereza”, në Bulevardin kryesor të Tiranës. Brenda mjediseve të shkollës, stafi, studiot dhe pajisjet e nevojshme janë të ndara në disa ambiente ose atelie, siç janë: Viti i Bazave të Përgjithshme, Grafikë Dizajn, Pikturë, Skulpturë, Pikturë e Aplikuar, Multi Media, Qeramikë, Tekstil dhe Modë, Fotografi, Video, Kompjuter. Këto atelie kanë një marrëdhënie konstruktive dhe interaktive. Studentët pranohen në atelienë e zgjedhur prej tyre në mënyrë që ata të kenë mundësinë të studiojnë në një mjedis të specializuar. Njëkohësisht mësimdhënia dhe procesi që ndiqet, krijojnë hapësirat për bashkëpunim me pedagogët, stafin, si dhe inkurajojnë punën në grup dhe bashkëveprimin midis tyre.

Pranë këtij fakulteti gjatë më shumë se 50 vjetëve të ekzistencës së tij, janë diplomuar më shumë se 1200 artistë

Fakulteti i Arteve të Bukura ka rreth 318 studentë, 46 pedagogë dhe ofron rreth 7 programe studimi dhe diploma Bachelor dhe Master në Arte.

Trupa pedagogjike pranë FM përbëhet nga 10 Prof., Prof. Asoc. Dhe Dr, ashtu si dhe 36 lektorë një pjesë e të cilëve me Diploma dhe Master të fituar në shkolla të njohura Europiane.

Një pjesë shumë e rëndësishme e programit të shkollës dhe aktivitetit të saj, përveç studiove të artit, pajisjeve dhe laboratorëve, është Galeria e Fakultetit të Arteve Pamore (FAP). Në këtë Galeri ekspozohen jo vetëm punë të studentëve, por dhe të artistëve të tjerë

Libraria e Fakultetit është një vend i rëndësishëm ku studentët dhe stafi jo vetëm marrin informacion, por zhvillojnë dhe kërkime të lidhura me procesin mësimor.



Këtë vit ne patëm numrin më të madh të studentëve të regjistruar, (281 studentë) që ka shënuar historiku shkollës sonë.

Që prej vitit 2008 Fakulteti i Arteve të Bukura ka përshtatur strukturën e re universitare (sipas Kartës së Bolonjës) me dy cikle mësimore.

Fakulteti i Arteve të Bukura ofron studimet dhe diplomat “Bachelor” dhe “Master në Artet e Bukura” në 7 programe studimi si më poshtë:

Në Fakultetin e Arteve të Bukura:

- Pikturë Grafike (Bachelor + Master në Artet e Bukura)
- Pikturë Tekstili dhe Mode (Bachelor + Master në Artet e Bukura)
- Pikturë Multimedia (Bachelor + Master në Artet e Bukura)
- Pikturë Kavaleti (Bachelor + Master në Artet e Bukura)
- Pikturë Monumentale (Bachelor + Master në Artet e Bukura)
- Skulpturë (Bachelor + Master në Artet e Bukura)
- Skulpturë Qeramike (Bachelor + Master në Artet e Bukura)

Fakulteti i Arteve të Bukura kryen dhe inkurajon një proces studimi, përgatitje dhe praktikimi të artit të mësimdhënies, i cili mund të karakterizohet si kërkues, eksperimentues, që nuk pranon atë që “aktualisht pritet prej tij”, duke qënë vazhdimisht pjesë aktive në diskutimet dhe zhvillimet e artit bashkëkohor, brenda dhe jashtë vendit.

Studentët e Fakultetit të Arteve të Bukura pranohen dhe ndjekin programin e shkollës në vitin e parë, jo të ndarë në specialitete, por në atë që quhet Viti i Bazave të Përgjithshme. Në këtë kurs, ku mësimdhënia në atelie orientohet në katër drejtime kryesore, studentët janë bashkë si në procesin praktik, ashtu dhe në studime të teorisë, historisë së artit, procese teknike dhe workshop-e. Në këtë fazë ata njihen me konceptet kyçe të formimit artistik.

